

Përshëndetje,

Në vijim të kërkesës së depozituar në formë elektronike, me anë të së cilës keni kërkuar mendimin e AMA-s lidhur me pikën 17, të nenit 33 të projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10221, date 04.02.2020 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, ju sqarojmë sa më poshtë:

Ndryshimi i propozuar parashikon se *“Mediat kombëtare kanë detyrimin që të publikojnë vendimet e diskriminimit të Komisionerit me objekt gjuhën e urrejtjes”*.

Lidhur me këtë propozim vërejmë se në bazë të ligjit organik nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, AMA rregullon vetëm veprimtarinë e subjekteve audio/audiovizivë.

Po sipas këtij ligji, konkretisht në nenin 34 të tij, përcaktohet detyrimi për Ofruesit e Shërbimeve Mediatike Audiovizive (OSHMA) për transmetimin e informacioneve pa shpërblim. Në këtë dispozitë parashikohet se: *“Organet e pushtetit dhe të administratës shtetërore vendore kanë të drejtë t’u kërkojnë OSHMA-ve të transmetojnë pa shpërblim komunikata të shkurtra, që paraqesin interes të veçantë për publikun e zonave ku ato transmetojnë dhe që kanë të bëjnë me mbrojtjen e shëndetit, fatkeqësitë natyrore dhe njerëzore, rendin publik dhe sigurinë kombëtare.”* Në këtë nen nuk përfshihet detyrimi për publikimin e vendimeve të diskriminimit të Komisionerit me objekt gjuhën e urrejtjes.

Autoriteti i Mediave Audiovizive propozon që detyrimi i sipërcituar, që *“Mediat kombëtare kanë detyrimin që të publikojnë vendimet e diskriminimit të Komisionerit me objekt gjuhën e urrejtjes”*, të mos përfshihet.

Faleminderit!



AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Tel : +355 4 223 3006

Mobile : +355 67 303 3000

e-mail : info@ama.gov.al

Adresa : Rr. "Papa Gjon Pali II", Nr. 15, 1010 , Tiranë

www.ama.gov.al